



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nr.1273/5 prot.**

**Datë 14.05.2026**

**V E N D I M**

**Nr. 649/2026**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 14.05.2026, shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:**

Vendim për mbylljen e çështjes së ankesës së operatorit ekonomik “FMAC” SHPK, nga autoriteti kontraktor, në procedurën e prokurimit “*E hapur*”, me nr. REF-82598-04-20-2026, me objekt: “*Rinovimi i sistemeve elektrike, i automatizimit dhe i sistemeve SCADA, për Stacionin e Pompave Turan*”, me fond limit 183,240,035.41 lekë pa tvsh, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 06.05.2026 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Korçë SH.A.

Vazhdimi i procedurës së shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës.

Modifikimi i dokumenteve të procedurës së mësipërme të prokurimit.

**Ankimues:**

Operatori ekonomik “FMAC” SHPK me me NUIS M02303026K dhe adresë: Njesia Bashkiake Nr. 10, Rruga e Kavajes, Qendra Sun Toëer, Kati 8, Apartamenti 30, Tiranë.

**Autoriteti Kontraktor:**

Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Korçë SH.A Rajoni Nr.1, Rruga: “Boris Plumbi”, Nr. 20, Korçë.

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar; Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”; Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi

**Vëren:****I***Vlerësimi Paraprak*

I.1. Vlëra limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimes ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

**II***Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 21.04.2026, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “E hapur”, me nr. REF-82598-04-20-2026, me objekt: “Rinovimi i sistemeve elektrike, i automatizimit dhe i sistemeve SCADA, për Stacionin e Pompave Turan”, me fond limit 183,240,035.41 lekë pa tvsh, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 06.05.2026 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë SH.A.

II.2. Në datën 24.04.2026 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2026/6583, protokolluar me

nr. 1273/2026 prot, datë 27.04.2026, e operatorit ekonomik "FMAC" SHPK, me anë të së cilës kërkohet modifikimi i dokumenteve të procedurës së mësipërme të prokurimit.

Konkretisht në ankesë pretendohet si vijon:

#### *"I. SHKELJA E PARE NE KETE PROCEDURE:*

*Ne Dokumenti DST - Shtojca 5 FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE të këtij tenderi, është kërkuar si më poshtë:*

*- Fletë garanci me afat minimal 10 vjet për pajisjet/mallrat: transformatorë, invertera, elektropompa, SCADA dhe elementët e saj.*

*Argumenti yne kundër kriterit te vendosur:*

*Kërkesa për fletë-garanci me afat minimal 10 vjet për transformatorë, invertera, elektropompa, SCADA dhe elementët e saj paraqitet e tepruar, joproporcionale dhe në kundërshtim të hapur me praktikën standarde të tregut, duke përbërë një barrierë të panevojshme dhe kufizuese për pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, në shkelje të parimit të konkurrencës dhe të proporcionalitetit të parashikuar në nenin 2 dhe nenin 3 i Ligjit Nr. 162/2020 Për prokurimin publik me ndryshime . Një afat i tillë nuk përfaqëson në asnjë mënyrë praktikën standarde të tregut për këto kategori pajisjesh:*

*- garancia e zakonshme e ofruar nga prodhuesit për pajisje të tilla rezulton përgjithësisht në intervale dukshëm më të ulëta, zakonisht rreth 12 deri në 24 muaj, ndërsa në disa raste ofrohen zgjatje të veçanta deri në 36 muaj, por jo si standard 10-vjeçar. Për më tepër, Direktiva Europiane 2019/771 Për shitjen e mallrave , e cila ka ndikuar drejtpërdrejt në harmonizimin e legjislacionit vendas, përcakton si standard minimal të detyrueshëm një garanci prej 2 vitesh, duke konfirmuar kështu se edhe kuadri european i mbrojtjes së konsumatorit është dukshëm nën pragun e kërkuar nga ky kriter. Vendosja e një afati garancie 10-vjeçar, në mungesë të çdo justifikimi teknik apo ligjor mbështetës, tejkalon çdo standard të njohur të tregut dhe të legjislacionit european, duke kufizuar artificialisht konkurrencën dhe duke përjashtuar de facto operatorë ekonomikë të kualifikuar që ofrojnë pajisje të prodhuesve të njohur ndërkombëtarë, në kundërshtim me nenin 77 dhe nenin 4 të Ligjit Nr. 162/2020.*

*Bazuar në arsyetimin e mësipërm, kërkojmë heqjen e këtij kriteri dhe modifikimin e tij me alternativa më të moderuar, rishikimin e afatit të garancisë në përputhje me standardet reale të tregut dhe legjislacionin vendas dhe European në fuqi, konform nenit 36 Specifikimet teknike të Ligjit Nr. 162/2020, me qëllim garantimin e një konkurrence të lirë, efektive dhe të bazuar në kriteret objektive e proporcionale me natyrën e mallrave të kërkuara.*

#### *II. SHKELJA E DYTE NE KETE PROCEDURE:*

*Ne Piken 2.2.3 te DST Shtojca 7- kërkohet te permbushet kriteri si me poshte:*

*2.2.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë:*

*a. 1 (një) Inxhinier Elektrik*

*b. (një) Inxhinier Mekanik*

*c. 1 (një) Inxhinier Elektronik*

*Nga analiza e detajuar qe i kemi bere objektit te procedurës se prokurimit dhe preventivin e përcaktuar në dokumentin Preventiv\_Rinovimi\_Turan\_(00).pdf , rezulton se punimet e parashikuara janë të sektorit elektrik dhe mekanik, duke e bërë kërkesën për inxhinier*

elektronik të pajustificuar dhe joproporcionale me natyrën reale të objektit të prokurimit, në shkelje të hapur të parimit të proporcionalitetit dhe të konkurrencës të parashikuar në nenin 2 të Ligjit Nr. 162/2020 Për prokurimin publik, si edhe të nenit 77 Kërkesat për kualifikim të ligjit, i cili kërkon që kriteret e përzgjedhjes të jenë të lidhura drejtpërdrejt dhe proporcionale me objektin e kontratës. Punimet në fjalë lidhen kryesisht me instalime, montime dhe integrimi të natyrës elektrike, mekanike dhe të automatizimit industrial, fusha këto që nuk kërkojnë domosdoshmërisht formimin specifik të një inxhinieri elektronik.

Edhe në rastet kur objekti përfshin elementë si PLC dhe SCADA, këto sisteme mbulohen dhe realizohen në praktikë edhe nga inxhinierë elektrikë, të automatizimit apo të kontrollit, të cilët disponojnë formimin dhe kapacitetin e nevojshëm teknik për projektim, programim, integrim dhe vënie në punë të sistemeve të tilla. Kjo konfirmohet dhe nga vetë dokumentacioni i tenderit, i cili në pikën 2.2.4 parashikon shprehimisht inxhinier elektrik të automatizimit industrial me certifikim për PLC dhe SCADA, duke pranuar kështu në mënyrë shteruese se ky formim profesional është i mjaftueshëm dhe i përshtatshëm për mbulimin e të gjitha nevojave teknike të kontratës. Ekzistenca e dy kërkesave paralele dhe të mbivendosura për të njëjtën fushë kompetence përbën një mospërputhje të brendshme të dokumentacionit të tenderit dhe konfirmon karakterin e tepërt e të pajustificuar të kërkesës për inxhinier elektronik, në kundërshtim me nenin 36 të Ligjit Nr. 162/2020, i cili parashikon: specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar.....

Për rrjedhojë, ky kusht është qarte i panevojshëm për realizimin me sukses të kontratës dhe krijon një barrierë të pajustificuar në pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, duke kufizuar konkurrencën e hapur dhe të barabartë, në kundërshtim me nenin 3 të Ligjit Nr. 162/2020. Në këtë kuadër, kërkojmë rishikimin e këtij kriteri dhe heqjen e kërkesës për drejtues teknik inxhinier elektronik, si një kusht i tepërt, joproporcional dhe i mbivendosur me kërkesat ekzistuese të dokumentacionit, konform Ligjit Nr. 162/2020 të Prokurimit Publik, me qëllim garantimin e një konkurrence të lirë, efektive dhe të bazuar në kritere objektive në raport me natyrën reale të objektit të prokurimit.

### III. SHKELJA E TRETE NE KETE PROCEDURE:

Ne piken 2.2.4 të DST, Shtojca 7 kërkohet të permbushet kriteri si më poshte:

2.2.4 Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

- 2 (dy) Inxhinierë Elektrik me profil Automatizimi industrie, ku të paktën njëri prej tyre të jetë certifikuar për:

- o. Softëare programimi PLC dhe SCADA
- o. Profesionist Rrjeti Nderjmarrje i Sigurisë Kibernetike
- o. Specialist Ndermarrjeje i Sigurisë Kibernetike
- o. Specialist për invertera.

Se pari, theksojmë se kërkesa për Inxhinierë Elektrik me profil Automatizimi Industrie të specializuar për Profesionist Rrjeti Ndërmarrjeje i Sigurisë Kibernetike dhe Specialist Ndërmarrjeje i Sigurisë Kibernetike është një kriter është i papërshtatshëm dhe kufizues, pasi specializimet në sigurinë kibernetike të rrjeteve të ndërmarrjes nuk janë të lidhura domosdoshmërisht me profilin e inxhinierisë elektrike. Në praktikë, këto specializime mund të zotërohen nga profesionistë të fushës së teknologjisë së informacionit, rrjeteve, softëare-it ose

sigurisë kibernetike, pa qenë domosdoshmërisht inxhinierë elektrikë. Për rrjedhojë, kërkesa për t i bashkuar këto specializime me profilin e inxhinierit elektrik me automatizim industrial krijon një kriter artificial, jo proporcional dhe kufizues për pjesëmarrjen. Eshte evidente se ne kete procedure eshte ngushtuar në mënyrë artificiale konkurrenca me qellim për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. Ne kete kuader , kërkojmë heqjen e kushtëzimit dhe kriterit diskriminues që këto specializime të mbahen domosdoshmërisht nga një inxhinier elektrik me profil automatizimi industrial dhe riformulimin e kriterit në mënyrë që të lejohet përmbushja e tij edhe nga profile të tjera të përshtatshme profesionale.

Së dyti, në dokumentin raport\_teknik\_i\_gjendjes\_ekzistuese.pdf është kërkuar edhe dorëzimi i dokumentacionit As-Built për sistemin që do të ndërtohet. Në këto kushte, vlerësojmë se kriteret e kualifikimit duhet të plotësohen domosdoshmërisht edhe me kërkesën për një Inxhinier Elektrik me profil Automatizimi Industrial, të pajisur me licencë projektimi kategoria 4G. Kjo për arsye se dokumentacioni teknik i vënë në dispozicion nuk përmban detajime të mjaftueshme për zbatim të plotë në terren, çka bën të nevojshme jo vetëm evidentimin e ndryshimeve sipas gjendjes faktike gjatë realizimit të punimeve, por edhe përgatitjen e detajeve teknike shtesë, vizatimeve të zbatimit dhe vizatimeve për prodhim (ëorkshop draëings). Për pasojë, mungesa e një profili të tillë në kriteret e kërkuara nuk është në përputhje me vetë kërkesat e dokumentacionit të tenderit, ndërsa prania e tij është e domosdoshme për të garantuar korrektësinë teknike dhe përputhshmërinë e zgjidhjeve që do të zbatohen.

Për sa më sipër, kërkojmë që kriteret e kualifikimit të rishikohet duke shtuar edhe kërkesën për një Inxhinier Elektrik me profil Automatizimi Industrial, të pajisur me licencë projektimi kategoria 4G.

#### **IV. SHKELJA E KATERT NE KETE PROCEDURE:**

Ne piken 2.2.5 te DST, Shtojca 7 kërkohet te permbushet kriteri si me poshte:

2.2.5 Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/ të kualifikuar, minimumi si më poshtë:

- a. 4 (katër) Specialistë Elektricistë
- b. 2 (dy) Specialistë mekanikë
- c. 1 (nje) shofer kamioni vinç
- d. 1 (nje) Manovrator minieskavatori
- e. 2 (dy) punëtorë krahu

Arsyetojme se : Kërkesa për 'Specialistë mekanikë' është formuluar në mënyrë të paqartë dhe evazive, duke krijuar hapësirë për interpretim arbitrar gjatë vlerësimit të ofertave, në shkëlje të parimit të transparencës dhe të trajtimit të barabartë të parashikuar në nenin 2 të Ligjit Nr. 162/2020 Për prokurimin publik . Termi 'specialist mekanik' nuk përfaqëson një kategori të qartë, të standardizuar dhe lehtësisht të verifikueshme në raport me kualifikimet profesionale, certifikimet apo licencimet përkatëse, në kundërshtim me nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020, i cili kërkon që kriteret e përzgjedhjes të jenë të përcaktuara qartë, objektivisht të verifikueshme dhe të lidhura drejtpërdrejt me objektin e kontratës. Në praktikë, për punime të natyrës mekanike, kualifikimet dhe certifikimet lidhen me profile profesionale konkrete dhe të njohura, si montator, saldator ose profesione të tjera të ngjashme, dhe jo me një emërtim të përgjithshëm

e të papërcaktuar si 'specialist mekanik', i cili në mungesë të kriterëve të qarta vlerësimi rrezikon të aplikohet në mënyrë jo uniforme ndaj operatorëve ekonomikë, duke cenuar objektivitetin dhe krahasueshmërinë e ofertave, në kundërshtim me nenin 33 të Ligjit Nr. 162/2020.

Për sa më sipër, kërkojmë që termi 'specialist mekanik' të zëvendësohet me profile profesionale konkrete dhe të përcaktuara qartë, si montator, saldator apo të tjera sipas natyrës së punimeve, të shoqëruara me kualifikimet ose certifikimet përkatëse të verifikueshme, konform nenit 36 të Ligjit Nr. 162/2020.

#### V. SHKELJA E PESTE NE KETE PROCEDURE:

Ne piken 2.2.6 te DST, Shtojca 7 kërkohet te permbushet kriteri si me poshte:

...Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 15 persona. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit... .

Nga një analizë e detajuar e Dokumenteve Standarde të Tenderit (DST) dhe objektit të prokurimit, rezulton se kriteri i kërkuar për një numër minimal prej 15 punonjësish në listëpagesë nuk është i mjaftueshëm për të provuar kapacitetin real teknik dhe organizativ të operatorit ekonomik në raport me objektin e kontratës. Vetë dokumentacioni i tenderit specifikon 15 role teknike të dedikuara për realizimin e projektit (3 inxhinierë drejtues teknik, 2 inxhinierë automatizimi, 4 elektrikistë, 2 specialistë mekanikë, 1 shofer, 1 operator mjeti rrethim dhe 2 punëtorë krahu), çka do të thotë se pragu minimal përputhet saktësisht me stafin e dedikuar për projektin, pa reflektuar asnjë kapacitet për personel tjetër mbështetës të domosdoshëm për realizimin e plotë dhe në kohë të punimeve. Duke marrë në konsideratë volumin e punimeve (instalim i 7 transformatorëve me 15 cela përkatëse, 2 km linjë TM, 9 800 m shtrim kabëll fibre optike, sistem SCADA redundante, 12 panele shpërndarjeje dhe kontrolli me PLC, prej të cilave 2 në konfigurim redundant, pompa me fuqi deri 550 kW me VFD përkatëse), kompleksitetin e tyre dhe karakterin shumëdisiplinor që përfshin punime demolimi, elektrike në tension të mesëm, mekanike, automatizimi, konfigurimi dhe vënia ne pune.

Nga sa më sipër rezulton qarte se realizimi i kontratës kërkon domosdoshmërisht edhe angazhimin e personelit mbështetës, përfshirë menaxher projekti për koordinimin ndërdisiplinor, planifikues të grafikut të punimeve për ndjekjen dhe përditësimin e vazhdueshëm të planit të zbatimit në disa fronte paralele, inxhinier për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë/ HSE? sipas Ligjit 10237/2010 PËR SIGURINË DHE SHËNDETIN NË PUNË, i ndryshuar është i detyrueshëm për punimet me tension të mesëm dhe gërmime, specialistë të kontrollit të cilësisë (QA/QC), staf logjistik dhe magazinier për menaxhimin e pajisjeve me vlerë të lartë, topograf për gjurmimin e linjave, si dhe staf të prokurimeve, financës, administratës dhe asistencës ligjore të shoqërisë. Për më tepër, kohëzgjatja e kontratës prej 55 javësh tejkalon periudhën e pushimit vjetor ligjor të përcaktuar në Nenin 92 të Kodit të Punës, gjatë së cilës çdo i punësuar përfiton minimalisht 22 dite pune pushim per 1 vit.

Në këtë kuadër, nga një analizë objektive e nevojave të kontratës dhe praktikave të BE rezulton se operatori ekonomik duhet të disponojë një strukturë minimale prej jo më pak se 35 punonjësish në listëpagesë, për të garantuar përmbushjen e plotë të detyrimeve kontraktore. Për rrjedhojë, kriteri i vendosur nuk pasqyron në mënyrë të plotë dhe reale kërkesat për burime

*njerëzore të nevojshme për realizimin e kontratës dhe, si i tillë, rezulton i pamjaftueshëm dhe joproporcional në raport me natyrën dhe kompleksitetin e objektit të prokurimit, në kundërshtim me parimin e proporcionalitetit të sanksionuar në Ligjin 162/2020 Për Prokurimin Publik . Për këto arsye, ky kriter duhet të rishikohet në drejtim të përcaktimit më funksional dhe të lidhur drejtpërdrejt me kërkesat konkrete të zbatimit të projektit.*

#### **VI. SHKELJA E GJASHTE NE KETE PROCEDURE:**

*Ne piken 2.2.7 te DST, Shtojca 7 kërkohet te permbushet kriteri si me poshte:*

*2.2.7 Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës:*

<i>Nr.</i>	<i>Lloji i Makinerive / Pajisjeve</i>	<i>Statusi</i>	<i>Sasia</i>
<i>1</i>	<i>Autovinc min 10 ton</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
<i>2</i>	<i>Minieskavator</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
<i>3</i>	<i>Automjet teknik për transport pajisjesh dhe ekipeve në terren</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
<i>4</i>	<i>Kamera inspektimi termografike</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
<i>5</i>	<i>Testues per instalime (Multifunksional Installation Tester)</i>		
	<i>Perfshirre RCB</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
<i>6</i>	<i>Laptop ose stacion programim</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
<i>7</i>	<i>Licenca për softëare dhe programim të pajisjeve (SCADA, HMI, PLC)</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>

*Vlerësojmë se kriteri mbi pajisjet dhe mjetet nuk është ndërtuar në mënyrë të plotë dhe funksionale në raport me objektin e kontratës. Ndërkohë që janë kërkuar një sërë pajisjesh, nuk janë përfshirë mjete thelbësore që lidhen drejtpërdrejt me realizimin, testimin dhe vënien në punë të punimeve elektrike, të instrumentimit dhe të automatizimit. Konkretisht, mungon testuesi i izolacionit (Megger), i domosdoshëm për verifikimin e gjendjes së izolacionit të kablllove dhe pajisjeve elektrike, pa të cilin pranimi teknik i instalimeve nuk mund të kryhet sipas standardeve në fuqi. Po ashtu, mungon kalibruesi i instrumentave (gjeneratori i sinjalit 420 mA), pajisje e domosdoshme për konfigurimin, simulimin dhe vënien në punë të sensorëve të presionit, nivelit dhe instrumentave te tjere që integrohet me sistemin PLC dhe SCADA, si dhe për testimin e loop-eve të kontrollit dhe vënien në punë të sistemeve PLC dhe SCADA. Duke pasur ne fokus objektin e kontrates, eshte e dukshme se mungesa e këtyre pajisjeve percjell faktin se kriteri nuk është harmonizuar me natyrën reale të punimeve dhe nuk pasqyron kërkesat teknike minimale që duhen për ekzekutimin cilësor, testimin dhe vënien në punë të objektit të kontratës.*

*Për pasojë, ky kriter nuk shërben si tregues i plotë dhe objektiv i kapacitetit teknik të operatorit ekonomik .*

*Për këto arsye, kërkohet që kriteri të modifikohet dhe të plotësohet me pajisjet e mësipërme, në mënyrë që lista përfundimtare të reflektojë kërkesat reale teknike të projektit.*

## VII. SHKELJA E SHTATE NE KETE PROCEDURE:

Ne dokumentin *specifikimet.pdf*, *Specifikime teknike te materialeve elektrike, mekanike dhe hidraulike ne faqet 36 38 te dokumentit*, përshkruan *specifikimet teknike per pompat 550 kW dhe pompat 305 kW ku përcaktohet specifikisht kërkesa per materialin e kermillit si ne vijim: ... Materiali i kermillit: Bronz.. pika 6.2.1- fq 36 dhe pika 6.2.2 fq 37.*

*Nga analiza teknike rezulton se specifikimi i materialit të kermillit vetëm si bronz përbën një kufizim të panevojshëm të konkurrencës, pasi nuk shoqërohet me një justifikim teknik të mjaftueshëm për përjashtimin e materialeve të tjera ekuivalente. Fakt që përbën shkelje të parimeve baze te Ligjit Nr. 162/2020 Për prokurimin publik te cilat janë udhëheqësit e nje procedure prokurimi dhe ndalon qartazi përfshirjen në dokumentacionin e tenderit të kërkesave teknike që kufizojnë pa arsye konkurrencën.*

*Në veçanti per aplikime me ujë të pijshëm, edhe çeliku inox përbën një alternativë teknikisht të përshtatshme dhe të përdorur gjerësisht, duke ofruar karakteristika të mira në aspektin e rezistencës ndaj korrozionit, qëndrueshmërisë dhe përshtatshmërisë për shërbimin e kërkuar. Në mungesë të një argumentimi teknik specifik që ta bëjë bronzin zgjidhjen e vetme të pranueshme, kufizimi vetëm në këtë material nuk rezulton i domosdoshëm me objektin e kontratës, por sjell ngushtim të pajustificuar të pjesëmarrjes ne kete procedure prokurimi. Për të garantuar te drejta te barabarta te operatoreve ekonomik me alternativa teknikisht ekuivalente, kërkojmë që specifikimi për materialin e kermillit të mos kufizohet vetëm në bronz, por të lejohet edhe materialin inoks.*

## VIII. SHKELJA E TETE NE KETE PROCEDURE:

Ne dokumentin *specifikimet.pdf*, *Specifikime teknike te materialeve elektrike, mekanike dhe hidraulike ne faqet 39-40 specifikon të dhënat teknike si më poshtë:*

- *Tipi: Valvul galixhant (automatic control valve, pilot-operated)*
- *Model i rekomanduar: CLA-VAL 90-01 (ose e ngjashme) me reduktim presioni, sipas funksionit te rezervuarit*
- *Diametri nominal (ON): 300*
- *Presioni nominal (PN): 16*
- *Materiali i trupit: Gize duktil EN-GJS-400-15, i veshur me epoksi 2: 250 ?m*
- *Disku/plug: bronz/alumin-bronz ose inox AISI 316*
- *Sedilja: EPDM/NBR rezistent ndaj ujit te pijshem*
- *Flanxhat: EN 1092-1 PN16*

### 6.3.2. Elementet e setit per montim ne rezervuar

*Seti i plote perfshin:*

- *Valvula kryesore CLA-VAL DN300 PN16 ose e ngjashme*
- *Pilot kontrolli sipas funksionit:*
- *Pilot per kontroll niveli (altitude pilot)*

*Sipas nje analize teknike kërkesat e mesiperme paraqesin paqartësi dhe mospërputhje, pasi përshkruajnë valvul galixhant me pilot për kontroll niveli (altitude pilot), ndërkohë që disa nga specifikimet dhe modeli i dhënë si shembull CLA-VAL 90-01 (ose e ngjashme) me reduktim presioni i referohen një valvule reduktuese presioni. Kjo përbën shkelje pasi paqartësia mbi llojin real të pajisjes së kërkuar dhe funksionin që ajo duhet të përmbushë lë hapësirë për interpretime të ndryshme nga operatorët ekonomikë duke shkaktuar konfuzion. Sa me sipër*

cenon rende krahasueshmërinë dhe vlerësimin objektiv të ofertave, në kundërshtim me Ligjin Nr. 162/2020 te PP, i cili kërkon që kërkesat teknike të jenë të qarta, të plota.

Për rrjedhojë, kërkojmë saktësimin e specifikimeve teknike në dokumentacionin perkates me qëllim përcaktimin e qartë të llojit të valvulës së kërkuar dhe funksionit të saj.

#### **IX. SHKELJA E NENTE NE KETE PROCEDURE:**

Ne dokumentin *specifikimet.pdf*- Specifikime teknike të materialeve elektrike, mekanike dhe hidraulike, faqet nga 11-16 Specifikime teknike për drive (VSD) (VFD) kërkesat teknike janë të paplota.

Lidhur me specifikimin e lartepërmendur kemi evidentuar se jepen specifikime për VFD me fuqi 600 kW, ndërsa mungojnë të dhënat dhe specifikimet teknike për VFD me fuqi 350 kW. Si rrjedhim dokumentacioni është i mangët dhe krijon paqartësi.

Për këtë arsye, kërkojmë plotësimin e dokumentacionit me specifikimet teknike të plota edhe për VFD me fuqi 350 kW konform objektivit të kontratës .

#### **X. SHKELJA E DHJETE NE KETE PROCEDURE:**

Ne dokumentin "*specifikimet.pdf*"- Specifikime teknike të materialeve elektrike, mekanike dhe hidraulike, faqet nga 16-19 kërkesat për serverët SCADA, kërkesat teknike janë të paplota. përcakton se sistemi duhet të ketë 3 serverë, përkatësisht 2 në konfigurim redundant dhe 1 server për databazën e arkivimit, si edhe 3 kompjuter operatori.

Megjithatë, në dokumentacion e cituar me sipër janë paraqitur të dhëna teknike vetëm për një server, ndërsa mungojnë të dhënat për serverin e databazës së arkivimit. Po ashtu, në preventiv janë kërkuar vetëm 1 copë server dhe 1 copë kompjuter operatori dhe specifikimet e paraqitura në preventiv nuk përputhen me kërkesat e dokumentit *specifikimet.pdf*. Theksojme se operatorët ekonomikë nuk mund të ofertojnë mbi baza të qarta kur dokumentacioni teknik është i mangët dhe kur ekziston mospërputhje e drejtpërdrejtë sasiore dhe cilësore midis specifikimeve teknike dhe preventivit.

Për rrjedhojë, kërkojmë plotësimin dhe saktësimin e dokumentacionit, si për të dhënat teknike të serverit të databazës së arkivimit, ashtu edhe për unifikimin e kërkesave teknike me preventivin e pajisjeve të kërkuara.

#### **XI. SHKELJA E NJEMBEDHJETE NE KETE PROCEDURE:**

Ne dokumentin *specifikimet.pdf*- Specifikime teknike të materialeve elektrike, mekanike dhe hidraulike, faqet nga 16-19 kërkesat për serverët SCADA, PLC dhe HMI, kërkesat teknike janë të paplota.

Nga ana teknike PLC përbën një nga elementët themelorë të sistemit të automatizimit, por në specifikimet teknike nuk është përcaktuar asnjë kërkesë teknike për PLC-të e parashikuara në sistem, duke përbërë një mungesë thelbësore të dokumentacionit.

Po ashtu, edhe pse në arkitekturën e SCADA kërkohet që PLC në stacionin e Turanit të jetë redundant, mungojnë plotësisht të dhënat teknike mbi arkitekturën dhe konfigurimin e këtij sistemi redundant, dhe në të njëjtën mënyrë mungojnë specifikimet teknike për HMI-të e parashikuara në sistem, duke e bërë të paqartë si llojin e pajisjeve që kërkohen, ashtu edhe nivelin real të performancës dhe funksionalitetit që duhet të ofrohet.

*Mungesa e specifikimeve teknike për komponentë kaq kritikë të sistemit të automatizimit lë hapësirë për zgjidhje të ndryshme teknike që nuk mund të krahasohen në mënyrë objektive dhe të drejtë ndërmjet operatorëve ekonomikë, në kundërshtim me Ligjin Nr. 162/2020, të cilët kërkojnë që kërkesat teknike të të plota, koherente në të gjithë dokumentacionin.*

*Për këtë arsye, kërkojmë që dokumentacioni teknik të plotësohet me specifikimet e nevojshme për PLC-të e puseve, rezervuarëve dhe sistemit të klorinimit, për PLC-në redundant të stacionit të Turanit, si dhe për HMI-të e parashikuara në sistem, në mënyrë që kërkesat të jenë të qarta, të plota dhe të njëjta për të gjithë operatorët ekonomik, për mos të konfunduar kriteret.*

## **XII. SHKELJA E DYMBEDHJETE NE KETE PROCEDURE:**

*Ne dokumentat puset.pdf, projekti\_2.PDF , lista\_e\_vizatimeve.PDF , General\_SCADA\_System\_Architecture.PDF , projekti1.PDF , linja\_kabllore.PDF , projekti\_4.PDF , raport\_teknik\_i\_gjendjes\_ekzistuese.pdf , projekti.pdf , projekti\_3.pdf , projekti\_5.PDF përbëjnë vizatimet teknike të projektit të përfshira në dokumentacionin e tenderit por që paraqesin vetëm pjesërisht sistemin e shpërndarjes elektrike dhe pamjet ballore të panelit, ndërkohë që mungojnë plotësisht vizatimet që përfshijnë sistemin e kontrollit (PLC), instrumentat matës dhe inverterat (VFD).*

*Kjo përbën një mungesë thelbësore të dokumentacionit teknik që cenon drejtpërdrejt aftësinë e operatorëve ekonomikë për të kuptuar, dimensionuar dhe ofertuar saktë zgjidhjen teknike të kërkuar. Vizatimet teknike të projektit nuk janë thjesht dokumente ilustruese, por përbëjnë bazën e domosdoshme mbi të cilën operatorët ekonomikë mbështesin zgjedhjet e tyre teknike, dimensionimin e pajisjeve, planifikimin e integritetit të sistemeve dhe llogaritjen e kostos së ofertës.*

*Mungesa e vizatimeve për sistemin e kontrollit, instrumentat matës dhe inverterat ? komponentë këta që përbëjnë thelbin funksional të sistemit të automatizimit dhe të menaxhimit të procesit ? e bën të pamundur vlerësimin e plotë të ndërveprimeve ndërmjet nënsistemeve, të kërkesave për kabllim dhe lidhje, si dhe të logjikës së kontrollit që duhet të zbatohet.*

*Kjo mungesë është edhe më e theksuar duke pasur parasysh se në dokumentacion mungojnë gjithashtu dokumente bazë dhe të domosdoshme të inxhinierisë së kontrollit, si lista e I/O-ve ? e cila përcakton të gjitha hyrjet dhe daljet e sistemit, modulet që nevojiten dhe është baza e pashmangshme për dimensionimin e saktë të PLC-së ? si dhe matrica shkak-pasojë, e cila përcakton logjikën e kontrollit, ndërveprimet ndërmjet sensorëve, sekuencat e alarmeve dhe veprimet automatike të sistemit.*

*Mungesa e këtyre dokumenteve fundamentale të inxhinierisë e bën të pamundur jo vetëm ofertimin e saktë, por edhe vlerësimin objektiv të ofertave nga autoriteti kontraktor, duke lënë hapësirë të gjerë për interpretime të ndryshme dhe zgjidhje teknike të pakrahasueshme ndërmjet operatorëve ekonomikë.*

*Për rrjedhojë, kërkojmë plotësimin e dokumentacionit teknik me vizatimet e plota të projektit, duke përfshirë skemën e sistemit të kontrollit (PLC) me arkitekturën dhe lidhjet e tij me pajisjet periferike, si dhe me dokumentet bazë të inxhinierisë së kontrollit, përfshirë listën e plotë të I/O-ve dhe matricën shkak-pasojë, në mënyrë që dokumentacioni të pasqyrojë në mënyrë të plotë dhe të saktë të gjithë sistemin që do të instalohet dhe të lejojë ofertimin dhe vlerësimin objektiv e të barabartë.*

### **XIII. SHKELJA E TREMBEDHJETE NE KETE PROCEDURE:**

*Njekohesishte ne teresi dokumentacioni i tenderit dhe specifikimet teknike e ngarkuara nga Autoriteti ne sistemin e Agjensise se Prokurimit Publik kemi evidentuar se nuk parashikohet asnjë kërkesë për monitorimin e gjendjes së punës së transformatorëve përtej matjes bazë të rrymës dhe tensionit. Per sa me siper megjithëse e nevojshme, rezulton e pamjaftueshme për të siguruar një monitorim të plotë dhe parandalues të gjendjes reale të transformatorit. Matja e rrymës dhe tensionit tregon vetëm parametrat elektrikë të momentit, por nuk është në gjendje të identifikojë në stadin fillestar defektet e brendshme të transformatorit si mbinxehja, shkarkimet elektrike dhe degradimi i izolimit, të cilat në mungesë të detektimit të hershëm evoluojnë në dështime katastrofike.*

*Në keto lloj sitemesh me ujë, transformatorët përbëjnë elementë kyç të infrastrukturës elektrike, dështimi i të cilëve shkakton ndërprerjen e plotë të funksionimit të të gjithë sistemit, me pasojë të drejtpërdrejta për furnizimin e popullsisë me ujë të pijshëm, duke e bërë monitorimin parandalues jo një opsion, por një domosdoshmëri teknike proporcionale me rëndësinë e infrastrukturës.*

*Ne keto objekte parashikohet sisteme te monitorimit online si Teknologjia e analizës së gazeve të tretur në vaj (DGA ? Dissolved Gas Analysis) nëpërmjet analizatorëve të vajit të instaluar direkt në transformator mundëson monitorimin e vazhdueshëm dhe në kohë reale të gjendjes së transformatorit, duke identifikuar në mënyrë të besueshme dhe të hershme çdo anomali të brendshme përpara se ajo të evoluojë në dështim. Një avantazh thelbësor i këtij sistemi është se ai mund të integrohet plotësisht në platformën SCADA të parashikuar tashmë në projekt, duke siguruar një nivel profesional e proporcional mbrojtjeje për një infrastrukturë të rëndësishë së veçantë. Integrimi në SCADA do të mundësonte gjithashtu alarmimin automatik, historikun e të dhënave dhe vendimmarrjen e informuar nga operatori, duke e shndërruar monitorimin reaktiv në monitorim aktiv dhe parandalues.*

*Gjithashtu, instalimi dhe komisioni i sistemit të monitorimit online të gazeve në transformatorë kërkon inxhinier elektrik të certifikuar për Sistem Monitorimi Online të Gazeve në Transformatorë, certifikim ky që duhet të përfshihet si kërkesë e detyrueshme në kriteret e kualifikimit të personelit teknik, me qëllim garantimin e instalimit, kalibrimit dhe integritetit të saktë të pajisjes në sistemin SCADA.*

*Për këto arsye, kërkojmë që dokumentacioni i tenderit të plotësohet me kërkesën për sistem monitorimi online të gazeve të tretur në vaj për transformatorët e parashikuar në projekt, të integruar në platformën SCADA, si dhe me kërkesën për inxhinier elektrik të certifikuar për instalimin dhe komisionimin e këtij sistemi, në mënyrë që të garantohet një nivel i plotë dhe profesional i mbrojtjes dhe monitorimit parandalues të infrastrukturës kritike të ujësjellësit.”*

II.3. Bazuar në nenin 112, pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Në datën 05.05.2026 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr.1273/1 prot., Vendimi i KSHA-së nr. 440/19 prot., datë 04.05.2026, ardhur nëpërmjet sistemit të ankesave eletronike të KPP-së dhe në datën 06.05.2026 është protokolluar në KPP me nr.

1273/2 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr. 440/20 prot., datë 04.05.2026 me objekt: “Dërgim i vendimit për ankesën e “FMA” SHPK në procedurën REF-82598-04-20-2026 dhe dokumentacionit shoqërues”, bashkëngjitur Vendimi i KSHA-së nr. 440/19 prot., datë 04.05.2026 dhe dokumentacioni plotësues. Referuar vendimit të KSHA-së rezulton se ankesa e operatorit ekonomik “FMAC” SHPK është pranuar pjesërisht nga ky komision.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës dhe dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit të autoritetit kontraktor

#### Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “FMAC” SHPK për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit “E hapur”, me nr. REF-82598-04-20-2026, me objekt: “Rinovimi i sistemeve elektrike, i automatizimit dhe i sistemeve SCADA, për Stacionin e Pompave Turan”, me fond limit 183,240,035.41 lekë pa tvsh, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 06.05.2026 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë SH.A, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Referuar vendimit të KSHA-së nr.440/19 prot., datë 04.05.2026 rezulton se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës ka pranuar pretendimet e ankimuesit, lidhur me pikat 1, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 10 dhe 13 të ankesës.

III.1.2. Neni 30 i LPP-së parashikon shprehimisht se:

*“Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.”*

III.1.3. Neni 115 pika 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i cili parashikon shprehimisht se:

*“Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:*

*a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:*

*i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;*

*ii. e ankesës/ ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;*

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.”

Për këtë arsye, KPP do të mbyllë shqyrtimin e çështjes në lidhje me këtë pjesë të pranuar nga autoriteti kontraktor për ankesën e operatorit ekonomik “FMAC” SHPK, me numër ankimi elektronik A/2026/6583 datë 24.04.2026, protokolluar me nr. 1273/2026 protokoli, datë 27.04.2026. Autoriteti kontraktor duhet të publikojë në sistemin e prokurimit elektronik, shtojcën me ndryshimet përkatëse, sipas vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave.

III.2. Lidhur me pretendimet e ankimuesit të parashtruara në pikën 2 dhe 3 të ankesës se:

“II. SHKELJA E DYTE NE KETE PROCEDURE:

Ne Piken 2.2.3 te DST Shtojca 7- kërkohet te permbushet kriteri si me poshte:

2.2.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

a. 1 (një) Inxhinier Elektrik

b. (një) Inxhinier Mekanik

c. 1 (një) Inxhinier Elektronik

Nga analiza e detajuar që i kemi bërë objektit të procedurës së prokurimit dhe preventivin e përcaktuar në dokumentin Preventiv\_Rinovimi\_Turan\_(00).pdf , rezulton se punimet e parashikuara janë të sektorit elektrik dhe mekanik, duke e bërë kërkesën për inxhinier elektronik të pajustificuar dhe joproporcionale me natyrën reale të objektit të prokurimit, në shkëlqje të hapur të parimit të proporcionalitetit dhe të konkurrencës të parashikuar në nenin 2 të Ligjit Nr. 162/2020 Për prokurimin publik , si edhe të nenit 77 Kërkesat për kualifikim të ligjit, i cili kërkon që kriteret e përzgjedhjes të jenë të lidhura drejtpërdrejt dhe proporcionale me objektin e kontratës. Punimet në fjalë lidhen kryesisht me instalime, montime dhe integritime të natyrës elektrike, mekanike dhe të automatizimit industrial, fusha këto që nuk kërkojnë domosdoshmërisht formimin specifik të një inxhinieri elektronik.

Edhe në rastet kur objekti përfshin elementë si PLC dhe SCADA, këto sisteme mbulohen dhe realizohen në praktikë edhe nga inxhinierë elektrikë, të automatizimit apo të kontrollit, të cilët disponojnë formimin dhe kapacitetin e nevojshëm teknik për projektim, programim, integrim dhe vënie në punë të sistemeve të tilla. Kjo konfirmohet dhe nga vetë dokumentacioni i tenderit,

i cili në pikën 2.2.4 parashikon shprehimisht inxhinier elektrik të automatizimit industrial me certifikim për PLC dhe SCADA, duke pranuar kështu në mënyrë shteruese se ky formim profesional është i mjaftueshëm dhe i përshtatshëm për mbulimin e të gjitha nevojave teknike të kontratës. Ekzistenca e dy kërkesave paralele dhe të mbivendosura për të njëjtën fushë kompetence përbën një mospërputhje të brendshme të dokumentacionit të tenderit dhe konfirmon karakterin e tepërt e të pajustificuar të kërkesës për inxhinier elektronik, në kundërshtim me nenin 36 të Ligjit Nr. 162/2020, i cili parashikon : specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar.....

Për rrjedhojë, ky kusht është qarte i panevojshëm për realizimin me sukses të kontratës dhe krijon një barrierë të pajustificuar në pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, duke kufizuar konkurrencën e hapur dhe të barabartë, në kundërshtim me nenin 3 të Ligjit Nr. 162/2020. Në këtë kuadër, kërkojmë rishikimin e këtij kriteri dhe heqjen e kërkesës për drejtues teknik inxhinier elektronik, si një kusht i tepërt, joproporcional dhe i mbivendosur me kërkesat ekzistuese të dokumentacionit, konform Ligjit Nr. 162/2020 të Prokurimit Publik, me qëllim garantimin e një konkurrence të lirë, efektive dhe të bazuar në kritere objektive në raport me natyrën reale të objektit të prokurimit.

### III. SHKELJA E TRETË NE KETE PROCEDURE:

Ne piken 2.2.4 të DST, Shtojca 7 kërkohet të përmbushet kriteri si më poshtë:

2.2.4 Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:  
- 2 (dy) Inxhinierë Elektrik me profil Automatizimi industriale, ku të paktën njëri prej tyre të jetë certifikuar për:

- o. Softëare programimi PLC dhe SCADA
- o. Profesionist Rrjeti Nderjmarrje i Sigurisë Kibernetike
- o. Specialist Ndermarrjeje i Sigurisë Kibernetike
- o. Specialist për invertera.

Se pari, theksojmë se kërkesa për Inxhinierë Elektrik me profil Automatizimi Industri të specializuar për Profesionist Rrjeti Ndermarrjeje i Sigurisë Kibernetike dhe Specialist Ndermarrjeje i Sigurisë Kibernetike është një kriter është i papërshtatshëm dhe kufizues, pasi specializimet në sigurinë kibernetike të rrjeteve të ndërmarrjes nuk janë të lidhura domosdoshmërisht me profilin e inxhinierisë elektrike. Në praktikë, këto specializime mund të zotërohen nga profesionistë të fushës së teknologjisë së informacionit, rrjeteve, softëare-it ose sigurisë kibernetike, pa qenë domosdoshmërisht inxhinierë elektrikë. Për rrjedhojë, kërkesa për t i bashkuar këto specializime me profilin e inxhinierit elektrik me automatizim industrial krijon një kriter artificial, jo proporcional dhe kufizues për pjesëmarrjen. Është e evidente se në këtë procedurë është ngushtuar në mënyrë artificiale konkurrenca me qëllim për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. Në këtë kuadër, kërkojmë heqjen e kushtëzimit dhe kriterit diskriminues që këto specializime të mbahen domosdoshmërisht nga një inxhinier elektrik me profil automatizimi industrial dhe riformulimin e kriterit në mënyrë që të lejohet përmbushja e tij edhe nga profile të tjera të përshtatshme profesionale.

Së dyti, në dokumentin raport\_teknik\_i\_gjendjes\_ekzistuese.pdf është kërkuar edhe dorëzimi i dokumentacionit As-Built për sistemin që do të ndërtohet. Në këto kushte, vlerësojmë se kriteret e kualifikimit duhet të plotësohen domosdoshmërisht edhe me kërkesën për një Inxhinier

*Elektrik me profil Automatizimi Industrial, të pajisur me licencë projektimi kategoria 4G. Kjo për arsye se dokumentacioni teknik i vënë në dispozicion nuk përmban detajime të mjaftueshme për zbatim të plotë në terren, çka bën të nevojshme jo vetëm evidentimin e ndryshimeve sipas gjendjes faktike gjatë realizimit të punimeve, por edhe përgatitjen e detajeve teknike shtesë, vizatimeve të zbatimit dhe vizatimeve për prodhim (ëorkshop draëings). Për pasojë, mungesa e një profili të tillë në kriteret e kërkuara nuk është në përputhje me vetë kërkesat e dokumentacionit të tenderit, ndërsa prania e tij është e domosdoshme për të garantuar korrektësinë teknike dhe përputhshmërinë e zgjidhjeve që do të zbatohen.*

*Për sa më sipër, kërkojmë që kriteret e kualifikimit të rishikohet duke shtuar edhe kërkesën për një Inxhinier Elektrik me profil Automatizimi Industrial, të pajisur me licencë projektimi kategoria 4G.”*

Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 2.2.3 dhe 2.3.4. e dokumentave të tenderit të publikuara në SPE, rezulton se nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar si vijon:

2.2.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- a. 1 (një) Inxhinier Elektrik
- b. 1 (një) Inxhinier Mekanik
- c. 1 (një) Inxhinier Elektronik

**Shënim:** Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e inxhinierëve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8.

Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues, për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, të kërkuar për këtë pikë.

**Për secilin inxhinier drejtues teknik duhet të paraqiten:**

- Kontratë individuale pune e vlefshme.
- Diploma e arsimit të lartë/licenca.
- Listepagesat e shoqërisë për të paktën tre muajt e fundit në të cilat inxhinieret e siperpermendur duhet të figurojnë.
- Dëshmi kualifikimi për sigurimin Teknik.
- Listepagesat e shoqërisë për të paktën për tre muajt e fundit: Janar, shkurt, Mars 2026, në të cilat inxhinierët drejtues teknikë të sipërpërmendur duhet të figurojnë.

2.2.4 Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

- 2 (dy) Inxhinierë Elektrik me profil Automatizimi industrie, ku të paktën njëri prej tyre të jetë certifikuar për:

- *Softëare programimi PLC dhe SCADA*
- *Profesionist Rrjeti Nderjmarreje i Sigurisë Kibernetike*
- *Specialist Nderjmarrejeje i Sigurisë Kibernetike*
- *Specialist për invertera .*

**Shënim:** Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e inxhinierëve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8.

Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues, për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, të kërkuar për këtë pikë.

***Për secilin inxhinier duhet të paraqiten:***

- *Kontratë individuale pune e vlefshme.*
- *Diploma përkatëse.*
- *Çertifikata/licenca përkatëse.*
- *Listëpagesat e shoqërisë për të paktën për tre muajt e fundit: Janar, shkurt, Mars 2026, në të cilat specialistët e sipërpërmendur duhet të figurojnë.*

III.2.2. Referuar vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave nr. 440/19 prot., datë 04.05.2026, lidhur me këto pretendime, nga ana e këtij komisioni është gjykuar si vijon:

*“KSHA pasi shqyrtoi pretendimet në ankesën e paraqitur, vlerëson se kërkesa për inxhinier elektronik si drejtues teknik, është e ekzagjeruar dhe joproporionale me përmasat reale të kontratës objekt prokurimi, sa i takon kërkit të inxhinierit në cilësinë e drejtuesit teknik në licencën e shoqërisë. Nga shqyrtimi në tërësi i specifikimeve teknike dhe preventivit të punimeve si dhe procesverbalit të argumentimit të kriterëve të hartuara nga njësia e prokurimit të autoritetit kontraktor rezulton se kërkesa për një inxhinier elektronik është i nevojshëm për realizimin e punëve si instalim i sistemit programimit ple, struktura e SCADA, komunikimin në distancë të pajisjeve elektronike dhe elektrike rrjetit ethernet, testimin e pajisjeve dhe mbrojtjen e tyre. Siguria kibernetike e sistemit, modemmat shperndaesat e internetit mos kene ndërhyrje të jashme të cilat mundtë cojnë në çorientimin e sistemit SCADA.*

*Sa i takon pretendimit se këto punime mund të kryhen nga një inxhinier elektrik me profil automatizimi të certifikuar për SCADA, KSHA gjykon se inxhinieri elektrik me profil autormatizimi të certifikuar për SCADA do të krijojë bllok-skemat elektrike mbi të cilat do të funksionojë sistemi automatik-manual-lokal, por këto pa u lidhur me sisteme të ndryshme komunikimi nuk realizohen. KSHA gjykon se pa suportin e inxhinierit elektronik ky sistem nuk vendoset në punë sepse nuk është komunikim vetëm i brendshem por është komunikim i jashtëm në distanca që kalojnë mbi 5 km. Moskomunikimi i këtyre pajisjeve në STP Turan ku është qendra e SCADA-s, sjell mosrealizimin e projektit. Në këtë kuptim KSHA vlerëson se kriteri duhet të modifikohet duke hequr kërkesën që inxhinieri elektronik të jetë drejtues teknik në licencën e shoqërisë dhe duke lënë kërkesën për inxhinier elektronik në stafin e shoqërisë*

*të cilin operatorët ekonomikë mund ta disponojnë me kontratë pune në funksion të realizimit të kontratës objekt ankimi.*

*Sa më sipër kriteri modifikohet si më poshtë vijon:*

*Pika 2.2.3 te DST shtojca 7 ishte:*

*2.2.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë:*

- a. 1 (një) Inxhinier Elektrik*
- b. 1 (një) Inxhinier Mekanik*
- c. 1 (një) Inxhinier Elektronik*

*Pika 2.2.3 te DST shtojca 7 bëhet:*

*2.2.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë:*

- a. 1 (një) Inxhinier Elektrik*
- b. 1 (një) Inxhinier Mekanik*

*Operatori ekonomik të disponojë në stafin e tij një inxhinier elektronik. KSHA gjykon që ky kriter, në funksion të unifikimit të kërkesave, të përfshihen në pikën 2.2.4 “Kapaciteti teknik” të kriterëve të vecanta për kualifikim shtojca 7 të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi.*

*Sa më sipër pretendimi i ankimuesit qëndron pjesërisht.*

*Lidhur me pretendimet e ankimuesit të parashtruara në pikën 3 të ankesës, [...], për kriterin 2.2.4 shtojca 7, të DT-vë, [...], pretendimet e ankimuesit qëndrojnë.*

**III.2.3. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:**

*“Qëllim i këtij ligji është:*

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”*

**III.2.4. Ndëkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:**

*“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*

*2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.2.5. Neni 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: *Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.*

III.2.6. Në nenin 77, pika 4, “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se:

*Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

*Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.*

*Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.*

III.2.7. Në nenin 84 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se:

*“1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta.*

*2. Operatori ekonomik mund ta shfrytëzojë aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale vetëm nëse subjekti tjetër i kryen punët ose do t’i sigurojë shërbimet për të cilat kërkohet aftësi e tillë.*

*3. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.*

*4. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të sigurohet se për subjektin, aftësinë e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij. Autoriteti ose enti kontraktor duhet t’i kërkojë operatorit ekonomik që të zëvendësojë subjektin që ndodhet në kushtet e skualifikimit apo të përjashtimit.*

*5. Nëse operatori ekonomik shfrytëzon aftësi nga subjekti tjetër në lidhje me kushtet që kanë të bëjnë me gjendjen ekonomike dhe financiare, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që operatori ekonomik dhe subjekti të ndërmarrin përgjegjësi solidare për zbatimin e marrëveshjes.*

6. Ndërkohë, në rastin kur operatorët ekonomikë mbështeten në kapacitetet e subjekteve të tjera, pasi këta të fundit do të kryejnë furnizimet, punët ose shërbimet, për të cilat kërkohen këto kapacitete, atëherë grupi i operatorëve ekonomikë mund të dorëzojë oferta ose të paraqitet si një kandidat i vetëm.

7. Në rastin e kontratave të punëve, shërbimeve dhe vendosjes ose instalimit në kuadër të një kontrate furnizimi, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që detyra/punë/aspekte kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjëri prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ofertues.”.

III.2.8. Në nenin 39, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet se:

“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve..”

III.2.9. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Komisioni vlerëson, se kriteret e kualifikimit duhet të jenë në përputhje me objektin e prokurimit, natyrën, aftësinë zbatuese, vlerën si dhe përmasat/volumin e kontratës. Në rastin konkret e rëndësishme për autoritetin kontraktor, referuar natyrës së kontratës është realizimi i objektit të prokurimit në përputhje me specifikimet teknike natyrën dhe përmasat e kontratës në fjalë.

Duke marrë shkas nga pretendimet e ankimuesit, për heqjen e kërkesës për inxhinier elektronik, ndërkohë që autoriteti kontraktor e ka hequr si kërkesë të parashikuar në pikën 2.2.3 në licencën e shoqërisë, por e kërkon si kapacitet të stafit të shoqërisë në pikën 2.2.4 të kriterëve të veçanta të kualifikimit, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoritetet kontraktore në hartimin e kriterëve dhe/ose specifikimeve teknike krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit duhet të kenë në vëmendje faktin se hartimi i tyre duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës. KPP thekson, se një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit janë ato të transparencës dhe trajtimit të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik. Kriteret e vendosura dhe/ose specifikimet teknike duhet të ofrojnë akses të barabartë për ofertuesit dhe nuk duhet të kenë efektin e krijimit të pengesave të pajustificuara për hapjen e prokurimit publik ndaj konkurrencës. Në hartimin e kriterëve dhe/ose specifikimeve teknike autoritet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi qoftë ato të dukshme qoftë ato të fshehta të cilat kanë të njëjtin efekt. Në asnjë rast kriteret dhe/ose specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një

produkti/mall/shërbim që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm. KPP gjykon, se parashikimet e mësipërme duhet të zbatohen në të gjitha procedurat e prokurimit, me përjashtim të rasteve ku vetë *lex specialis* parashikon një përjashtim të tillë. Në hartimin e kriterëve dhe/ose specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin, se kriteret dhe/ose specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 dhe 77 të LPP.

KPP gjykon se përcaktimi i stafit teknik të shoqërisë, duhet të vijë pas një analize të hollësishme të të gjithë elementëve të procedurës së prokurimit si volumi, natyra, grafiku i punimeve, afati i kontratës etj., sikundër parashikojnë dispozitat ligjore në fuqi.

Në procesverbalin e hartimit të specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim, kërkesa për disponimin e inxhinierit elektronik (jo domosdoshmërisht në licencën e shoqërisë), është argumentuar me nevojën për instalimin e sistemit të programimit plc, strukturën e scada, komunikimin në distance të paisjeve elektronike dhe elektrike rrjetin ethernet, testimin e paisjeve dhe mbrojtjen e tyre. Gjithashtu siguria kibernetike e sistemit, modemmat shpërndaesat e internetit mos kenë ndërhyrje të jashtme të cilat mund të çojnë në çorientimin e sistemit SCADA.

Autoriteti kontraktor në vendosjen e kriterëve të kualifikimit kërkon garanci në lidhje me përmbushjen me sukses dhe në afat të kontratës nga ana e operatorëve ekonomikë, të cilët duhet të dëshmojnë besueshmëri me kapacitetet e tyre. Komisioni sqaron se, subjektet ofertuese, të intersuara për të marrë pjesë në këtë procedurë prokurimi, me qëllim plotësimin e kërkesës së përcaktuar nga autoriteti kontraktor për inxhinier elektronik mund të mbështeten edhe në kapacitetet e subjekteve të tjera, referuar nenit 84 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, ose në cdo formë tjerë të parashikuar në legjislacionin e prokurimit publik si bashkim operatorës ekonomikë etj.

Për sa më sipër, pretendimet e ankimuesit qëndrojnë pjesërisht.

III.3. Lidhur me pretendimet e ankimuesit se: “*Ne dokumentin specifkimet.pdf- Specifikime teknike te materialeve elektrike, mekanike dhe hidraulike, faqet nga 11-16 Specifikime teknike per drive (VSD) (VFD) kërkesat teknike janë të paplota.*

*Lidhur me specifikimin e lartepërmendur kemi evidentuar se jepen specifikime për VFD me fuqi 600 kW, ndërsa mungojnë të dhënat dhe specifikimet teknike për VFD me fuqi 350 kW. Si rrjedhim dokumentacioni është i mangët dhe krijon paqartësi.*

*Për këtë arsye, kërkojmë plotësimin e dokumentacionit me specifikimet teknike të plota edhe për VFD me fuqi 350 kW konform objektit të kontratës”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.3.1. Në përgjigjen e dhënë ankimuesit, nëpërmjet vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave nr. 440/19 prot., datë 04.05.2026, autoriteti kontraktor ka sqaruar shprehimisht si vijon: “*KSHA, pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur, vlerëson se argumenti i ankimuesit lidhur me mungesën e specifikimeve teknike për VFD 350 kW, qëndron por KSHA gjykon se komunikimi dhe specifikimet teknike të VFD 600 kW janë të njëjta me ato të VFD 350 kW. Për këtë arsye KSHA gjykon se dokumentacioni teknik në lidhje me specifikimet e VFD-ve*

*është i plotë dhe i mjaftueshëm për qëllimet e prokurimit. Sa më sipër, KSHA nuk pranon këtë pretendim të ankimuesit "*

III.3.2. Neni 30 i LPP-së parashikon shprehimisht se:

*“Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.”*

III.3.3. Neni 115 pika 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se:

*“Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:*

*a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:*

*i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;*

*ii. e ankesës/ ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;*

*b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;*

*c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.*

*3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:*

*a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;*

*b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.”*

Për sa më sipër, megjithëse përgjigja e autoritetit kontraktor është mospranim i pretendimeve të ankimuesit, rezulton se autoriteti kontraktor, në fakt i ka pranuar ato kur shprehet se: *“KSHA, pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur, vlerëson se argumenti i ankimuesit lidhur me mungesën e specifikimeve teknike për VFD 350 kW, qëndron”* ndaj dhe KPP do të mbyllë shqyrtimin e çështjes në lidhje me to. Rrjedhimisht, në mbështetje të neneve 30 dhe pikat 1 dhe 2 të nenit

115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar i cili parashikon se: “Nëse operatorët ekonomikë të interesuar, nuk kanë paraqitur argumente që kundërshtojnë ankesën, sipas parashikimeve të kësaj pike, nuk mund të ushtrojnë më pas të drejtën e ankimit për vendimin e dhënë lidhur me ankesën për këtë procedurë prokurimi”, si dhe Urdhërit nr. 03, datë 11.01.2022 “Për Miratimin e Rregullores së Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, vendosi të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të pretendimeve të ankimuesit si dhe të vazhdojë procedurën e shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës. Autoriteti kontraktor duhet të publikojë në sistemin e prokurimit elektronik, shtojcën me ndryshimet përkatëse, të specifikimeve teknike për VFD 350 kW, sipas vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave.

III.4. Lidhur me pretendimet e ankimuesit se: “*XI. SHKELJA E NJEMBEDHJETE NE KETE PROCEDURE: Ne dokumentin specifikimet.pdf- Specifikime teknike te materialeve elektrike, mekanike dhe hidraulike, faqet nga 16-19 kerkesat per serverët SCADA, PLC dhe HMI, kërkesat teknike janë të paplota. Nga ana teknike PLC përbën një nga elementët themelorë të sistemit të automatizimit, por në specifikimet teknike nuk është përcaktuar asnjë kërkesë teknike për PLC-të e parashikuara në sistem, duke përbërë një mungesë thelbësore të dokumentacionit. Po ashtu, edhe pse në arkitekturën e SCADA kërkohet që PLC në stacionin e Turanit të jetë redundant, mungojnë plotësisht të dhënat teknike mbi arkitekturën dhe konfigurimin e këtij sistemi redundant, dhe në të njëjtën mënyrë mungojnë specifikimet teknike për HMI-të e parashikuara në sistem, duke e bërë të paqartë si llojin e pajisjeve që kërkohen, ashtu edhe nivelin real të performancës dhe funksionalitetit që duhet të ofrohet. Mungesa e specifikimeve teknike për komponentë kaq kritikë të sistemit të automatizimit lë hapësirë për zgjidhje të ndryshme teknike që nuk mund të krahasohen në mënyrë objektive dhe të drejtë ndërmjet operatorëve ekonomikë, në kundërshtim me Ligjin Nr. 162/2020, të cilët kërkojnë që kërkesat teknike të të plotë, koherente në të gjithë dokumentacionin. Për këtë arsye, kërkojmë që dokumentacioni teknik të plotësohet me specifikimet e nevojshme për PLC-të e puseve, rezervuarëve dhe sistemit të klorinimit, për PLC-në redundant të stacionit të Turanit, si dhe për HMI-të e parashikuara në sistem, në mënyrë që kërkesat të jenë të qarta, të plotë dhe të njëjta për të gjithë operatorët ekonomik, per mos te konfunduar kriteret.*

*XII. SHKELJA E DYMBEDHJETE NE KETE PROCEDURE: Ne dokumentat puset.pdf, projekti\_2.PDF , lista\_e\_vizatimeve.PDF , General\_SCADA\_System\_Architecture.PDF , projekti1.PDF, linja\_kabllore.PDF, projekti\_4.PDF , raport\_teknik\_i\_gjendjes\_ekzistuese.pdf , projekti.pdf , projekti\_3.pdf , projekti\_5.PDF përbëjnë vizatimet teknike të projektit të përfshira në dokumentacionin e tenderit por që paraqesin vetëm pjesërisht sistemin e shpërndarjes elektrike dhe pamjet ballore të panelit, ndërkohë që mungojnë plotësisht vizatimet që përfshijnë sistemin e kontrollit (PLC), instrumentat matës dhe inverterat (VFD).*

*Kjo përbën një mungesë thelbësore të dokumentacionit teknik që cenon drejtpërdrejt aftësinë e operatorëve ekonomikë për të kuptuar, dimensionuar dhe ofertuar saktë zgjidhjen teknike të kërkuar. Vizatimet teknike të projektit nuk janë thjesht dokumente ilustruese, por përbëjnë bazën e domosdoshme mbi të cilën operatorët ekonomikë mbështesin zgjedhjet e tyre teknike,*

*dimensionimin e pajisjeve, planifikimin e integritit të sistemeve dhe llogaritjen e kostos së ofertës.*

*Mungesa e vizatimeve për sistemin e kontrollit, instrumentat matës dhe inverterat ? Komponentë këta që përbëjnë thelbin funksional të sistemit të automatizimit dhe të menaxhimit të procesit ? e bën të pamundur vlerësimin e plotë të ndërveprimeve ndërmjet nënsistemeve, të kërkesave për kabllim dhe lidhje, si dhe të logjikës së kontrollit që duhet të zbatohet.*

*Kjo mungesë është edhe më e theksuar duke pasur parasysh se në dokumentacion mungojnë gjithashtu dokumente bazë dhe të domosdoshme të inxhinierisë së kontrollit, si lista e I/O-ve ? e cila përcakton të gjitha hyrjet dhe daljet e sistemit, modulet që nevojiten dhe është baza e pashmangshme për dimensionimin e saktë të PLC-së ? si dhe matrica shkak-pasojë, e cila përcakton logjikën e kontrollit, ndërveprimet ndërmjet sensorëve, sekuencat e alarmeve dhe veprimet automatike të sistemit.*

*Mungesa e këtyre dokumenteve fundamentale të inxhinierisë e bën të pamundur jo vetëm ofertimin e saktë, por edhe vlerësimin objektiv të ofertave nga autoriteti kontraktor, duke lënë hapësirë të gjerë për interpretime të ndryshme dhe zgjidhje teknike të pakrahasueshme ndërmjet operatorëve ekonomikë.*

*Për rrjedhojë, kërkojmë plotësimin e dokumentacionit teknik me vizatimet e plota të projektit, duke përfshirë skemën e sistemit të kontrollit (PLC) me arkitekturën dhe lidhjet e tij me pajisjet periferike, si dhe me dokumentet bazë të inxhinierisë së kontrollit, përfshirë listën e plotë të I/O-ve dhe matricën shkak-pasojë, në mënyrë që dokumentacioni të pasqyrojë në mënyrë të plotë dhe të saktë të gjithë sistemin që do të instalohet dhe të lejojë ofertimin dhe vlerësimin objektiv e të barabartë”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.4.1. Në rastin konkret, Komisioni gjykon, se objekti i pretendimit të operatorit ekonomik ankimues, në thelb, janë paqartësi mbi përmbushjen e kërkesave teknike të dokumentave të tenderit. Gjithashtu, KPP konstaton se autoriteti kontraktor, në kthimin e përgjigjes të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, ka sqaruar si vijon:

*“(Lidhur me pretendimet e ankimuesit të parashtruara në pikën XI të ankesës) KSHA pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur, vlerëson se dokumentacioni teknik në lidhje me PLC-të dhe HMI-të është i plotë dhe i mjaftueshëm për qëllimet e prokurimit, duke qenë se këto komponentë nuk janë pajisje të izoluara që kërkojnë specifikime të pavarura, por janë pjesë integrale e sistemit SCADA të kërkuar si set i plotë dhe funksional, ku parametrat teknikë të secilit komponent përcaktohen nga arkitektura e përgjithshme e zgjidhjes teknike që operatori ekonomik zgjedh të ofrojë. Një operator ekonomik i kualifikuar dhe i specializuar në sistemet e automatizimit industrial e kupton se kërkesat funksionale të përshkruara në dokumentacion, si monitorimi, kontrolli, redundancadhe komunikimi, përcaktojnë qartë nivelin e performancës së PLC-ve dhe HMI-ve të nevojshme, pa qënë e domosdoshme një listë e detajuar e parametrave teknike për secilin komponent vec e vec. Sa më sipër, KSHA nuk pranon pretendimet e ankimuesit.*

*(Lidhur me pretendimet e ankimuesit të parashtruara në pikën XII të ankesës) KSHA pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur, vlerëson se vizatimet teknike të përfshira në dokumentacionin e tenderit janë të mjaftueshme për të mundësuar ofertimin e saktë nga operatorët ekonomikë të kualifikuar, duke qënë se dokumentacioni i disponueshëm përshkruan në mënyrë të mjaftueshme arkitekturën e përgjithshme të sistemit, kërkesat funksionale dhe parametrat*

*kryesorë operativë. Bazuar në arkitekturën dhe vizatimet e dhëna, cdo operator ekonomik i specializuar në sistemet SCADA dhe automatizimin industrial është i aftë të interpretojë dhe të ofertojë mbi bazën e dokumentacionit ekzistues duke u mbështetur në njohuritë e tij profesionale, në bazë të zgjidhjes teknike që do të ofrojë për të përmbushur kërkesat teknike, funksionale dhe arkitekturën e kërkuar. Sa më sipër, KSHA nuk pranon këtë pretendim të ankimuesit.”*

III.4.2. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr.162/2021 “Për prokurimin publik”, parashikohet se: *Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efizienzën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

III.4.3. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr.162/2021 “Për prokurimin publik” thuhet se: *“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”*

III .4.4. Referuar nenit 21 “Autoriteti ose enti kontraktor” të ligjit nr.162/2021 “Për prokurimin publik”, “ 1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.”

III.4.5. Në nenin 36 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: *“Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.*

*Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.*

*Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.*

*2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.*

*3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:*

*a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;*

*b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;*

*c) kërkesave në terma funksionale sipas shkronjës "a", referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës "b" të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;*

*ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".*

*4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".*

*5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "b" të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.*

*6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "a" të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor."*

*III.4.6. Në nenin 75 "Sqarimet dhe ndryshimi në dokumentet e tenderit" të LPP-së thuhet shprehimisht se: "1. Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit*

*nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet t'i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor ose enti duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t'ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit. Në çdo rast, sqarimi i dokumenteve të tenderit nuk do të konsiderohet shtim, pakësim ose ndryshim i kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit.*

*2. Autoriteti ose enti kontraktor, nga momenti i shpalljes së njoftimit të kontratës deri përpara mbarimit të afatit të fundit për dorëzimin e ofertave dhe për çfarëdolloj arsyeje, me nismën e vet ose me kërkesë të palëve të interesuara, mund të vendosë të bëjë ndryshime në dokumentet e tenderit përmes hartimit të një shtojce. Nëse ndryshimi i dokumenteve të tenderit bëhet në gjysmën e parë të afatit të pranimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor mund të zgjasë afatin kohor të pritjes së ofertave. Nëse ndryshimi i dokumenteve të tenderit bëhet në gjysmën e dytë të afatit të pranimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor zgjat afatin kohor për dorëzimin e ofertës me të paktën 10 ditë për procedurat mbi kufirin e lartë monetar dhe me të paktën 7 ditë për procedurat nën kufirin e lartë monetar.*

*3. Çdo shtojcë për ndryshim të dokumenteve të tenderit komunikohet në të njëjtën mënyrë që është bërë publikimi i njoftimit të procedurës.”,*

III.4.7. Sa më sipër cituar rezulton se objekti i pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues janë paqartësi mbi kërkesat teknike të dokumentave të tenderit. Autoriteti kontraktor ka dhënë sqarime por KPP gjykon se këto sqarime nuk janë shteruese, pasi autoriteti kontraktor nuk ka shpjeguar qartësisht dhe konkretisht paqartësitë e ankimuesit për specifikimet e nevojshme për PLC-të e puseve, rezervuarëve dhe sistemit të klorinimit, për PLC-në redundant të stacionit të Turanit, si dhe për HMI-të e parashikuara në sistem, si dhe nuk jep informacion të detajuar lidhur me pretendimet e ankimuesit për mungesën e dokumentacionit teknik me vizatimet e plota të projektit, duke përfshirë skemën e sistemit të kontrollit (PLC) me arkitekturën dhe lidhjet e tij me pajisjet periferike, si dhe me dokumentet bazë të inxhinierisë së kontrollit, përfshirë listën e plotë të I/O-ve dhe matricën shkak-pasojë, në mënyrë që dokumentacioni të pasqyrojë në mënyrë të plotë dhe të saktë të gjithë sistemin që do të instalohet dhe të lejojë ofertimin dhe vlerësimin objektiv e të barabartë, në mënyrë që ofertesit të qartësohen lidhur me hartimin e ofertës teknike dhe ekonomike.

Për pasojë, KPP gjykon se autoriteti kontraktor, përveçse të sqarojë ankimuesin në mënyrë shteruese për të gjitha paqartësitë e tij, këto sqarime dhe ndryshime të dokumentave të tenderit duhet tu bëhen me dije edhe ofertuesve të interesuar për procedurën e mësipërme të prokurimit, në përputhje me përcaktimet e nenit 75 të LPP-së si më sipër cituar.

Sa më sipër pretendimet e ankimuesit qëndrojnë.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023

*“Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik njëzëri,*

### **Vendosi**

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “FMAC” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur”, me nr. REF-82598-04-20-2026, me objekt: *“Rinovimi i sistemeve elektrike, i automatizimit dhe i sistemeve SCADA, për Stacionin e Pompave Turan”*, me fond limit 183,240,035.41 lekë pa tvsh, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 06.05.2026 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë SH.A.
2. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “FMAC” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit.
3. Autoriteti kontraktor, të kryejë sqarimet dhe modifikimet përkatëse në përputhje me vendimin e KSHA-së dhe arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet dhe sqarimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.
4. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimes “FMAC” SHPK.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Gjergj Mersini**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

